



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE I TEKNOLOGJIE	
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVIT-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org.	Nr. Prot.
Org. Jedinica	Prot. No.
Org. Unit	Date
Nr. faqeve	Datë
Br. stranica	
No. pages	
Prishtine, 14.05.2021	

Republika e Kosovës - Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education, and Science Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Nëpunësve Publik, Parashtresave dhe Ankesave tjera

Numër: 2/1K 302
Datë: 14.05.2021

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të nëpunësve publik dhe Ankesa Tjera i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), në bazë të nenit 11, paragrafi 2, i Ligjit nr. 06/L – 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenin 6 paragraf. 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë si dhe Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm, Nr.2-235 , dt.14.02 2020, në cilësinë e Organit Epror bazuar në nenin 132 paragraf 4 ndërlidhur me nenin 2 paragraf 1, 1.1., 1.3, 2, 4, nenin 46, 47, 48, nenin 86 paragraf 1 dhe 2, nenin 88 paragraf 1 dhe 2, nenin 89, Ligjit për Procedurën Administrative, lidhur me Shqyrtimin e lëndës Nr.302 dt. 01.03.2021 , nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. APROVOHET E THEMELTË ANKESA Nr.302 dt. 01.03.2021 në bazë nenin 6 paragraf. 1 ndërlidhur me nenin 12, 13 dhe nenit 14 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë mbështetur me nenin 132 paragraf. 4 ndërlidhur me nenin 2 paragraf 1, 1.1., 1.3, 2, 4, nenin 86 paragraf. 1 dhe 2, nenin 88 paragraf. 1 dhe 2, nenin 89 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për mos marrjen e asnjë përgjigjeje në kërkesat e parashtruara pran MASHTI-it nga komisioni i Licencave për aprovimin e ndryshimit të emrit të Kolegjit dhe Departamenti i Arsimit të Lartë.

2. **Aprovohet ndryshimi i emërimit sipas Kërkesës së palës Nr.302 dt. 01.03.2021**, nga Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" në "Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca".
3. **OBLIGOHET** Komisioni për Shqyrtimin e kërkesave për Licencim të BPrAL në MASHTI-it- Departamenti i Arsimit të Lartë në MASHTI, të nxjerri Vendimin me emërtimin "Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca".
4. **OBLIGOHET** BPrAL që në funksion të këtij **Vendimi**, të veprojë në pajtueshmëri të plotë me ligjin për Arsimin e Lartë dhe të Udhëzimeve Administrative për Licencim dhe Akreditim, që studentët e këtij institucioni, të cilët i kanë përfunduar studimet apo janë në proces të përfundimit, para arritjes së kësaj marrëveshje, nuk do të dëmtohen, dhe të gjitha veprimet, të jenë në përputhje me direktivën 2005/36/EC të Komitetit Evropian dhe në përputhje me procesin e Bolonjës.
5. **OBLIGOHET Inspektorati Arsimor**, në pajtim me kompetencat që ka, të monitoroj zbatimin e këtij vendimi, në veçanti të mbikëqyrë zbatimin e **paragrafit 4** të këtij **Vendimi**.

Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij dhe është vendim përfundimtar.

A R S Y E T I M

Bartësit Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) – Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" me seli në Prishtinë, me datë 01.03.2020 ka parashtruar Ankesë me numër të protokollit nr. 302, në Ministrinë e Arsimit për mos marrjen e asnjë përgjigje nga komisioni i Licencave, lidhur me aprovimin për ndryshim të emrit të Kolegjit.

Në bazë të shkresave të lëndës nr. 302, Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" Ankesës i ka bashkangjitur të gjitha dokumentet dhe dëshmitë të kërkuara në bazë të nenit 7 paragr. 2.6 ndërlidhur me nenin 6 dhe 13 paragr. 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë.

Përveç dëshmimeve të kërkuara, Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" ka dorëzuar po ashtu përmes parashtrësës të datës 01.03.2021 si dëshmi edhe marrëveshjen me Alma mater Europaea, me seli në Salzburg-Austri, në të cilën Kolegji është bashkuar në aleancë me këtë institucion, si kampus i pestë i këtij institucioni, përmes së cilës Kolegji i ka përfunduar procedurën për ndryshimin e emrit të biznesit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës nga Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" në "Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca". Pastaj Certifikatën e Biznesit me nr. 810504200 në të cilën figuron në "Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca & Poliklinika Rezonanca".

Rrjedhimisht Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" i ka bërë përpjekje të vazhdueshme për informim në MAHTI lidhur me ndryshimin e emrit, ku në shkresën më datë

06.06.2019 me numër të protokollit 889/19H. Të njëjtën kërkesë e kanë dërguar përsëri më datë 26.09.2019 në MASHTI me numër të protokollit 1829/19H.

Po ashtu, pala, Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" në këtë rast, ka bashkangjitur si dëshmi edhe **kërkesën** e dt. 31.05.2019 drejtuar Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), lidhur me njoftimin e ndryshimit emrit të Kolegjit nga **Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca"** në **"Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca"**.

Kolegji ka bashkangjitur dëshmi tjera siç është kërkesa zyrtare drejtuar MASHTI-it-bartësve të arsimit të lartë- **komisionit të licencave** për aprovimin e ndryshimit të emrit nga Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" në "Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca". Mirëpo për kërkesën e lartshënuar, Departamenti i Arsimit të Lartë-zyrtarët përgjegjës, nuk i kanë kthyer asnjëherë përgjigje.

Gjithashtu lëndës i është bashkangjitur edhe **konfirmimi** nga Rektori drejtuar Ministrisë së Arsimit Shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit -Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa- përmes së cilës paraqet sqarimin e **marrëveshjes** së Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca" të bërë më datën 18.01.2016 me Alma Mater Europaea në Salzburg. Austria, ku Kolegji është bashkuar në aleancë me këtë institucion, si kampus i pestë i tij. Duke dhënë informata tjera lidhur me Alma Mater Europaea se ky institucion është një universitet ndërkombëtar me seli në qytetin austriak të Salzburgut, me kampuse në disa qytete evropiane.

Në marrëveshjen e prezantuar para Komisionit, në **nenin 2** është vendosur që Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" do të shfrytëzoj emrin e Alma Mater Europaea si dhe llogon e tij. Dhe se studentët që diplomojnë sipas kësaj marrëveshjes, do ti marrin diplomat sipas emrit të Alma Mater Europaea.

Njëkohësisht në këtë dokument, Rektori deklaron dhe vërteton se, studentët e Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca" të cilët i kanë përfunduar studimet para arritjes së kësaj marrëveshje, nuk do të dëmtohen asgjë, sepse programet e akreditimit janë në përputhje me direktivën 2005/36/EC të Komitetit Evropian dhe është në përputhje me procesin e Bilonjës, i cili parqet ciklin e parë të edukimit të lartë profesional, përkatësisht niveli 6 dhe 7 sipas KKK/EQF, pas gradimit do ti marrin titujt përkatës.

Gjithashtu, Komisioni konstaton edhe vendimin e datës 27.09.2019 me numër të prot 6-3462 në të cilin, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë ka lëshuar vendim për licencimin e Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca" por pa ndryshim të emrit sipas kërkesave të parashtruara pranë MASHTI-it, prandaj Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" më datë 04.10.2019 me numër të protokollit 3769 ka bërë kërkesë përsëri pranë Komisionit të Licencave për ndryshim të emrit të Kolegjit, pasi që përsëri nuk kanë marrë përgjigje, janë detyruar prapë më datë 01.10.2020 të bëjmë kërkesë në MASHT për ndryshim të emrit, me Kërkesën numër të protokollit 2451.

Në funksion të realizimit të kërkesës së vet, nëcilësinë e provave, pala i ka dërguar njoftimin e datës 4 Tetor 2019 në ora 15:20 nga z. Shkelzen Gërgjاليu(zyrtar i lartë pran AKA-s), përmes së cilës bënë "Njoftim ne lidhje me ndryshimin e emrit" tek : Burim Gashi <Burim.Gashi@rks-

gov.net>, Shpresa Mehmeti <Shpresa.Mehmeti@rks-gov.net> duke i mbajtur në informatë edhe Blerim Krasniqi <blerim.h.krasniqi@gmail.com> dhe Avni Gashin <Avni.Gashi@rks-gov.net>. Përmbajtja e "Njoftim ne lidhje me ndryshimin e emrit" është kjo, Citoj;

Ju njoftoj se në mbledhjen e saj nr. 78, të mbajtur me 27 Shtator 2019, Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka trajtuar kërkesën e Kolegjit Rezonanca nr. 1829/19H për ndryshim te emërimit të institucionit. Bazuar në këtë kërkesë, dhe bazuar ne Ligjin për Arsimin e Larte, dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr. 15/2018, KShC ka miratuar ndryshimin e emërimit të këtij institucioni. Agjencia e Kosovës për Akreditim njofton Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë se sa i përket procesit të akreditimit, emri i propozuar është kompatibil dhe në përputhje me kriteret e AKA-se. Gjithsesi mbetet kompetencë e MASHT për të aprovuar ndryshimet e tjera nëse ato janë ne harmoni me legjislacionin e përcaktuar. Mbaron Citati;

Komisioni konstaton se, më datë 27.09.2019 Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë ka lëshuar vendim me nr. 6-3462 për licencimin e Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca" por nuk e ka marr fare për bazë aprovimin e dërguar tek zyrtarët për ndryshim të emrit, nga Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" në "Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca". Andaj Komisioni për Shqyrtimin e kërkesave për Licencim dhe Rilicencim të BPrAL, nuk ka vepruar në përputhje me nenit 14 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-037 ndërlidhur me nenin 8 paragraf 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke mos zbatuar aprovimin nga AKK dhe mos i njohur palës të drejtën, sipas kërkesës së parashtruar. Bashkangjitur në ankesë vendimin e nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e kërkesave për Licencim dhe Rilicencim të BPrAL nr. 6-3462n i dt. 27.09.2019.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe Parashtresave në cilësinë e Organit Epror në MASHTI, ka pranuar ankesën për Shqyrtim dhe menjëherë ka analizuar ex-officio shkresat e lëndës dhe në bazë të nenit 86 paragr. 1 dhe 2 ndërlidhur me nenin 88 paragraf 1 dhe 2 dhe nenin 89 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme, ka analizuar të gjitha provat të bashkangjitura, dhe për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, është përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën e përgjithshme administrative dhe Ligji për Procedurën Kontestimore, andaj Komisioni i Ankesave ka vlerësuar, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në bazë të nenit 94 dhe nenin 95 paragraf 1, duke respektuar të drejtën e dëgjimit të palës ankuese, pala është ftuar në MASHTI për të paraqitur mendime, shpjegime dhe prova dhe për të dëgjuar mendimin e palës lidhur me pretendimet të parashtruara në ankesë.

Pala(Kolegji Rezonanca) përmes përfaqësuesit të sajë znj. Miranda Karamoni (sekretare e Kolegjit), është njoftuar po ashtu edhe me të drejtën që të bashkëpunoj në mirëbesim me organin publik në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes përkatëse pranë Komisionit të Ankesave sipas nenit 87 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Pas takimit me palën përkatësisht me përfaqësuesin e Kolegjit "Rezonanca" znj. Miranda Karamani, pala në mënyrë elektronike ka përcjellë në Komisionin e Ankesave edhe vendimet dhe shkresa – kërkesat, drejtuar MASHTI-t dhe AKA.

Mbi bazën e gjendjes faktike dhe juridike të vërtetuar nga Komisioni i Ankesave dhe bazë të **nenit 86 paragraf 1 dhe 2, neni dhe 88 paragraf 1 dhe 2 dhe nenin 89** të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas detyrës zyrtare, ka shqyrtuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative si dhe në mënyrë të pavarur, ka përcaktuar llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, dhe ka vlerësuar se nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes sipas bindjes së tij, ka përcaktuar së cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove, veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, andaj në bazë të **nenit 132 paragraf 4** të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme, si Organi Epror, në cilësinë e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, ka arritur në përfundim se Ankesa e palës së pakënaqur Kolegji "Rezonanca" është e bazuar dhe që të njëjtit kanë ofruar dëshmitë të nevojshëm dhe u takon ndërrimi i emrit nga Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" në **"Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca"**.

BPrAL obligohet që në funksion të zbatimit të këtij vendimi, të veprojë komfor ligjit për Arsimin e Lartë dhe në bazë të Udhëzimeve Administrative për Licencim dhe Akreditim, që studentët e Kolegjit të Shkencave Mjekësore Rezonanca" të cilët i kanë përfunduar studimet, apo janë në proces të përfundimit para arritjes së kësaj marrëveshje, nuk do të pengohen apo dëmtohen, dhe të gjitha veprimet të jenë në përputhje me direktivën 2005/36/EC të Komitetit Evropian dhe në përputhje me procesin e Bolonjës,

Duke marrë për bazë rrethanat objektive dhe situatën e shpjeguar më lartë mundësohet ndryshimi i emrit në vendimin e licencës nga Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" në **"Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca"**.

Komisioni i Ankesave, vlerëson lartë Marrëveshjen e arritur në mes të Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca" të bërë më datën 18.01.2016 me **Alma Mater Europaea në Salzburg**, Austria, duke qenë pjesë e këtij institucioni.

Shpresojmë se kjo marrëveshje dhe ky bashkëpunim, do të ndikoj në cilësinë e shërbimeve për studentët të cilët i drejtohen këtij Kolegji

Vendimi i Komisionit të Ankesave në bazë të **nenit 132 paragr. 4** të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është vendim përfundimtar.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave-MASHTI

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi palët të pakënaqur kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit për Konflikte Administrative brenda 30 dite nga data e nxjerrjes së këtij Vendimi përfundimtar.